



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 46 al. 2 të Ligjit për planifikimin dhe rregulimin e hapsirës ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 2/89), nenit 3 të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur me 13.06.2003 merr

V E N D I M

MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË AKADEMISË SË SHKENCËS DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS DHE OBJEKTIT TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit të Akademisë së shkencës dhe të arteve të Kosovës dhe objektit të Ministrisë së Arsimit, shkencës dhe teknologjisë, në Prishtinë

Neni 2

Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit të Akademisë së shkencës dhe të arteve të Kosovës dhe objektit të Ministrisë së Arsimit, shkencës dhe teknologjisë, në Prishtinë.

Lokacioni nga alinea 1. e këtij neni, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 7090/2, Komuna Kadastrale Prishtinë, sipërfaqëja afërsisht prej 47.00 ari pronë e Komunës.

Neni 3

Ky Vendim paraqet bazë për hartimin e Projektit Urbanistik të lokacionit nga alinea 2 e nenit 2 e këtij Vendimi në bazë të të cilit do të caktohen kushtet urbanistike-teknike për lejimin e ndërtimit të objekteve investive nga neni 1 i këtij vendimi.

Projekti urbanistik nga alinea 1 e këtij neni do të punohet nga Drejtorati i Planifikimit, urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës sipas programit të prezentuar nga investitori.

Neni 4

Projekti urbanistik i lokacionit sipas këtij vendimi do të inkorporohet me planin detal urbanistik të ardhëshëm për hapsirën e gjerë të asaj zone të zytetit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i Drejtorve i Komunës së Prishtinës, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtorati për Financa dhe Pronë të Komunës të Prishtinës do të kryejn veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR.535-1117 DT.19.06.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri